



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.185/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara ankesat e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, ZL.Anr.185/2025, ZL.Anr.186/2025, ZL.Anr.187/2025, ZL.Anr.188/2025, ZL.Anr.189/2025, dhe ZL.Anr.190/2025, të datës 11.10.2025, të paraqitura kundër subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

II. Subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi t'i largoj posteret dhe materialet zgjedhore nga vendet e hapësirave publike të përshkruara më ankesat e datës 11.10.2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.185/2025, ZL.Anr.186/2025, ZL.Anr.187/2025, ZL.Anr.188/2025, ZL.Anr.189/2025, ZL.Anr.190/2025 të datës 10.10.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Srpska Lista, ku në ankesën ZL.Anr.185/2025,

pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista kanë vërejtur se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, në fshatin Pridvoricë, komuna e Zubin Potokut kanë ngjitur materialin e tyre promocial në shtyllë elektrike, në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.186/2025, pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista kanë vërejtur se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në Komunën e Zubin Potokut, në fshatin Ugljarë, komuna Zubin Potok, kishin vendosur material promocial në shtyllë elektrike pranë fabrikës SIMPO, që është në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.187/2025, pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista kanë vërejtur se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në Komunën e Zubin Potokut, në fshatin Ugljarë, Zubin Potok, kishin vendosur material promocial në shtyllë elektrike në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.188/2025, pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista në komunën e Zubin Potokut, vunë re se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në këtë komunë, në fshatin Pridvoricë në Zubin Potok, kishin vendosur material promocial shtyllë elektrike, në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.189/2025, pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista në komunën e Zubin Potokut, vunë re se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në këtë komunë, në qendër të komunës së Zubin Potokut, duke e vendosur materialin promocial në një kioskë, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.190/2025, pretendohet se me datë 10.10.2025, aktivistët e Srpska Lista në komunën e Zubin Potokut, vunë re se subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në këtë komunë, në qendër të Zubin Potokut, kishin ngjitur materialin e tyre promocial në shtyllë elektrike në afërsi të qendrës zgjedhore, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në përgjigje në ankesat ZL.Anr.185/2025, ZL.Anr.186/2025, ZL.Anr.187/2025, ZL.Anr.188/2025, ZL.Anr.189/2025, ZL.Anr.190/2025, subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, pretendon se përkrahësit e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, kishin vendosur material promocial në disa lokacione në komunën e Zubin Potokut dhe kështu shkelën Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promocial të Za Slobodu, Pravdu i Opstanak në territorin e komunës së Zubin Potokut, dëshirojmë të theksojmë se me datë 11.10.2025, Panelit tuaj iu kishte dërguar një ankesë nga Srpska Lista, me pretekstin e shkeljes së dispozitave dhe kodit të sjelljes së subjekteve politike, të përkrahësve dhe kandidatëve të tyre për shumë shkelje. Ngjitja e afishave në rrugët e përmendura në komunën e Zubin Potokut dhe në vende të tjera, si dhe pretendimet se afishat janë ngjitur në banera ose janë ngjitur mbi materialin zgjedhor të një partie tjetër nga aktivistët tanë, nuk ka prova apo fotografi që dëshmojnë se ndonjë aktivist i yni e ka bërë këtë. Në realitet, ka ndodhur shpesh, veçanërisht në Veriun e Kosovës (Mitrovica e Veriut, Zubin Potok dhe Leposaviq), që afishat tona të hiqen nga vendet ku kemi leje ose nga lokalet private, dhe të keqpërdoren (praktikë nga zgjedhjet e fundit parlamentare). Me tutje në përgjigje theksojmë se në zgjedhjet e fundit parlamentare të shkurtit 2025 ishin ndëshkuar nga PZAP sepse kishin vendosur një baner afër një qendre zgjedhore dhe pas kësaj, sigurisht që nuk do të na vinte ndërmend të ngjisnim përsëri

afisha aty ku do të ketë diçka për votim. Përkundrazi, afishat tona janë hequr dhe janë ngjitur me qëllim që ne të ndëshkohemi, siç po ndodh në këtë rast në Shkollën Fillore "Jovan Cvijic".

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.185/2025, ZL.Anr.186/2025, ZL.Anr.187/2025, ZL.Anr.188/2025, ZL.Anr.189/2025, ZL.Anr.190/2025, të datës 11.10.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.185/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP, pasi që shqyrtoj ankesën, provat e bashkangjitura të njëjtës, dhe përgjigjes në ankesë, vëren se ankesat janë bazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve, përkatësisht ankesave ZL.Anr.185/2025, ZL.Anr.186/2025, ZL.Anr.187/2025, ZL.Anr.188/2025, ZL.Anr.189/2025, ZL.Anr.190/2025, dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Srpska Lista janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesat e parashtruara, paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, kjo për faktin se ky subjekt politik ka vendosur material promovues në hapësira publike (shtylla elektrike, kioska etj), andaj me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1 pika 2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin nen përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të qëndrueshme dhe të njëjtat i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor të mbajtur, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje. Po ashtu, Subjekti Politik, Za Slobodu, Pravdu i Opstanak ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte-shtylla publike, pa pëlqimin e organeve kompetente komunale, përbën shkelje të legjislacionit

zgjedhor, dhe të njëjtat shkelje janë sanksionuar me nenin 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1 pika 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli ka vlerësuar edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, mirëpo të njëjtat pretendime i vlerësoj si të pabazuara, për faktin se të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, ashtu siç përcaktohet me nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli vlerëson se lartësia e dënimit me gjobë i përgjigjet natyrës së shkeljes dhe praktikës së ndjekur nga paneli për raste të tilla. Pra, paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin e mbajtur zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje.

Paneli vlerëson se në rastin konkret, urdhërohet subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterat e vendosur në hapësirat publike, përkatësisht, shtyllat elektrike dhe kioske, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Prandaj si përfundim, paneli ka vlerësuar se veprimet e subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak janë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1 pika 2 dhe nenin 120 paragrafi 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në këtë kuptim, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.185/2025, datë 13.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.